

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr _____

V E N D I M
PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot me date 04, 02, 2005, para meje gjyqtares se Rrethit Tirane, M. Kulla, u paraqit nga Majd Nuri Shafiq, lindur me 12 dhjetor 1961, ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne qytetin e New Yorkut, i biri i Nuriut, me numer pasaporte 102402894, banues ne rr. Pjeter Bogdani, nr.13, kerkesa per te regjistruar si person juridik shoqerine "United Transportation Services sh.p.k. ». Pasi shqyrtova kerkesen e tij:

K O N S T A T O V A

Kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Majd Nuri Shafiq, ne cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise, per te regjistruar si person juridik shoqerine "United Transportation Services sh.p.k. ».

Selia e kesaj shoqerie eshte ne Rr Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane, Shqiperi.

Ortaku i vetem dhe administratori I kesaj shoqerise eshte zoti Majd Nuri Shafiq.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete e papercaktuar.

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie eshte 100 000 (njqind mije) Leke.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a. Marrjen, grumbullimin dhe shpermdarjen e kolive, pakove dhe zarfave normal dhe express te te gjitha llojeve dhe madhesive, brenda dhe jashte territorit te Republike se Shqiperise, me ane te transportit tokesor, detar dhe ajror.
- b. Perfaqesimin e shoqerive te huaja qe ushtrojne aktivitet ne kete lloj biznesi dhe te ofroje sherbimet e tyre ne Shqiperi.

c. Kryerjen e te gjitha procedurave dhe formaliteteve te zhdoganimit dhe te sherbimit per vete shoqerine dhe klientet e saj (individe ose shoqeri).

d. Kryerjen e te gjitha llojeve te sherbimit te transportit, brenda dhe jashte Shqiperise.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes profesionale.

Pasi shqyrtova kerkesen e zotit Majd Nuri Shafiq, cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze nenit 22 te ligjit 7632, date 4.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin ne regjistrin tregtar".

V E N D O S A:

Regjistrimin e shoqerise "United Transportation Services sh.p.k. » si person juridik. Selia e saj eshte ne Rr Pjeter Bogdani, Pall. Teuta, Tirane, Shqiperi.

Ortaku i vetem dhe administratori i kesaj shoqerise eshte zoti Majd Nuri Shafiq.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete e papercaktuar.

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie eshte 100 000 (njqind mije) Leke

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

a. Marrjen, grumbullimin dhe shperndarjen e kolive, pakove dhe zarfave normal dhe express te te gjitha llojeve dhe madhesive, brenda dhe jashte territorit te Republike se Shqiperise, me ane te transportit tokesor, detar dhe ajror.

- b. Perfaqesimin e shoqerive te huaja qe ushtrojne aktivitet ne kete lloj biznesi dhe te ofroje sherbimet e tyre ne Shqiperi.
- c. Kryerjen e te gjitha procedurave dhe formaliteteve te zhdoganimit dhe te sherbimit per vete shoqerine dhe klientet e saj (individe ose shoqeri).
- d. Kryerjen e te gjitha llojeve te sherbimit te transportit, brenda dhe jashte Shqiperise.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes profesionale.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Shkalles se Dyte.

GJYQTARE

Blerina Muça



V E N D I M
PER NDRYSHIMIN E EMERTIMIT TE SHOQERISE

Sot me date 05.07, 2005, para meje gjyqtares se Rrethit Tirane, Blerina Muça, u paraqit Zoti Majd Nuri Shafiq, lindur me 12 dhjetor 1961, ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne qytetin e New Yorkut, i biri i Nuriut, me numer pasaporte 102402894, banues ne rr. Pjeter Bogdani, nr.13, ne cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K.

Pasi shqyrtova kerkesen e tij:

K O N S T A T O V A

Kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Majd Nuri Shafiq, ne cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise, per te regjistruar ne Rregjistrin Tregtar , ndryshimin e emertimit te shoqerise UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K ne UNITED TRANSPORT SH.P.K.

UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K, eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, rregjistruar me vendimin Nr 31861 date 04.02.2005, te Gjykates se Rrethit Tirane.

- Ortak i vetem dhe administrator i kesaj shoqerie eshte Majd Nuri Shafiq
- Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100 000 Leke
- Selia e kesaj shoqerie eshte ne rrugen Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane, Shqiperi

Me daten 27 Qershor 2005, shoqeria UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K., ortaku i saj i vetem dhe perfaqesues i 100 % te kapitalit, mori keto vendime:

VENDIM 1

U VENDOS, ne baze te Seksionit V te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne baze te statutit te shoqerise, te ndryshohet emertimi i shoqerise nga UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K ne UNITED TRANSPORT SH.P.K.

VENDIM 2

U VENDOS qe si emer tregtar te shoqerise, per arsye publiciteti etj, te perdoret "UniTrans".

VENDIM 3

U VENDOS qe ky Vendim i ortakut te vetem per ndryshimin e emertimit te shoqerise te regjistrohet ne Gjykatën e Shkalles se Pare dhe ne Regjistrin Tregtar, Tirane. Zoti Majd Nuri Shafiq, ne cilesine e ortakut te vetem dhe te administratorit, autorizohet te ekzekutoje dhe te jape ne emer te shoqerise, cdo vertetim ose dokument te nevojshem per te permbushur dhe bere efektive vendimet e mesiperme, vecanerisht regjistrimin e tyre ne Gjykate.

Kerkohet qe sa me siper te regjistrohet ne Gjykatën e Shkalles se Pare dhe ne Regjistrin Tregtar, Tirane.

Pasi shqyrtova kerkesen e zotit Majd Nuri Shafiq, cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze nenit 7632, date 4.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrimin ne regjistrin tregtar".

V E N D O S A:


Ndryshimin e emertimit te shoqerise UNITED TRANSPORTATION SERVICES SH.P.K ne UNITED TRANSPORT SH.P.K..

Perdorimin, si emer tregtar te shoqerise, te emrit "UniTrans".

Ky ndryshim te depozitohet ne Regjistrin Tregtar.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Shkalles se Dyte.

GJYQTARE
Blerina Muça

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Blerina Muça', written over a horizontal line.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr 32861/2

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 18 / 07 / 2006, para meje gjyqtares se Rrethit Gjyqesor Tirane,
Arjana Caco u paraqit kerkesa per :

A. Depozitimin ne Regjistrin tregtar te kontrates per transferimin e pjeseve te kapitalit te shoqerise "United Transport " shpk, kontrate e noterizuar, date 2 qershor 2006, Nr. 3744 Rep, Nr. 1480 Kol .

B. Depozitimin ne Regjistrin Tregtar i Vendimit te Asamblese se Shoqerise United Transport shpk per transferimin e pjeseve te kapitalit te shoqerise.

Pasi shqyrtova kerkesen :

K O N S T A T O V A

Shoqeria "United Transport" shpk eshte nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston rregullisht sipas ligjeve te Shqiperise, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se rrethit Tirane, Nr. 32861, Date 4.02.2005 dhe reregjistruar me Vendimin Nr. 32861/1 Date 5.07.2005 .

- Administrator i kesaj shoqerie eshte Majd Nuri Shafiq.
- Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100 000 Leke dhe eshte i ndare ne 100 pjese me vlere nominale 1000 lek secila.
- Selia e kesaj shoqerie eshte ne rrugen Rr Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane, Shqiperi.

- Ortak i vetem ishoqerise eshte : Majd Nuri Shafiq, mbajtes i 100 pjeseve, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit themeltar.

MEQENESE

1. Me Vendim te ortakut te vetem te shoqerise United Transport sh.p.k., zotit Majd Nuri Shafiq , me date 02.06.2006, u vendos te transferohen 76 pjese te kapitalit themeltar qe perfaqesojne 76 % te Kapitalit te shoqerise tek shoqeria Union Grup sh.p.k.

2. Me Vendim te ortakeve te shoqerise Union Grup sh.p.k., zoterinjve Edmond Leka dhe Niko Leka, me date 02.06.2006, u vendos miratimi i blerjes se 76 pjeseve te kapitalit themeltar qe perfaqesojne 76 % te Kapitalit te shoqerise United Transport sh.p.k. prej ortakut te vetem zotit Majd Nuri Shafiq.

3. Ne baze te kontrates te Transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, ne formen e aktit noterial :

Date 2 Qershor 2006, Nr. 3744 Rep, Nr. 1480 Kol, ortaku i vetem Majd Nuri Shafiq, mbajtes i 100 pjeseve qe perfaqesojne 100% te kapitalit te "United Transport" shpk i datelindjes 1961, nenshtetas amerikan, me adrese banimi Rr Pjeter Bogdani Nr 13, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Nr.102402894, i ka shitur dhe transferuar pronesine e 76 pjeseve, qe perfaqesojne 76% te kapitalit te Shoqerise "United Transport "shpk, me një vlerë nominale prej 1000 (njëmijë) Leke secila, tek ortaku i ri, Union Grup sh.p.k. , shoqeri shqiptare, regjistruar me Vendim te Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, nr. 26016, date 26.05.2001, me adrese ne Bulevardi Zogu I, Pallati Edi-Com 13 Katesh, Tirana Albania, perfaqesuar ne menyre te rregullt nga administratori, z. Niko Leka.

SI RRJEDHIM, ortaket dhe pjeset perkatese te tyre ndryshojne si me poshte :

1.Majd Nuri Shafiq, zoteron 24 pjese, qe perfaqesojne 24 % te kapitalit.

2.Union Grup shpk, zoteron 76 pjese, qe perfaqesojne 76 % te kapitalit.

PER SA ME SIPER

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin ne regjistrin tregtar".


VENDOSA:

- Te pasqyrohet sa me siper ne Regjistrin Tregtar.
- Te depozitohet ne Regjistrin Tregtar kontrata e transferimit te 76 pjeseve te kapitalit themeltar qe perfaqesojne 76 % te Kapitalit te shoqerise United Transport sh.p.k. tek shoqeria Union Grup sh.p.k.
- Te depozitohet Vendimi i Ortakut te Vetem Shoqerise United Transport shpk date 2 qershor 2006 dhe dokumentat e tjere shoqerues te ketij transferimi.
- Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim ne Gjykatën e Shkalles se Dyte

GJYQTARE


Arjana Caco

(Gumborolli)



V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 22/1/2006 unë gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane  pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "United Transport" sh.p.k. z.Niko Leka, per depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "United Transport" sh.p.k.

K O N S T A T O V A:

Se shoqeria "United Transport" sh.p.k. eshte rregjistruar person juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr 32861 date 05.07.2005. Bazuar ne statutin e shoqerise dhe ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", asambleja e jashtezakonshme e ortakeve te shoqerise "United Transport" sh.p.k. me vendimin date 14.08.2006 ka vendosur:

- Pranimin e doreheqjes se Z. Majd Nuri Shafiq nga detyra e Administratorit te shoqerise "United Transport" sh.p.k. Tirane.
- Emertimin e Z. Niko Leka si administrator te ri te shoqerise.
- Ndryshimin e selise se shoqerise, nga „RR. Pjeter Bogdani, pallati Teuta, Tirane“, ne adresen e re „Bulevard Zogu I, pallati Edicom, perballe Stacionit te Trenit, Tirane.
- Te mandatoje Z. Niko Leka te ndjeke procedurat e nevojshme per pasqyrimin e ketyre ndryshimive ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te dates 14.08.2006 dhe pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktet e shoqese.

Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe 7638 date 1911.1992 „per Shoqerite tregtare „

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses,

- Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te : Vendimit date 14.08.2006 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "United Transport" sh.p.k.
- Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese.
- Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.
- Dergimin e nje kopje te ketij vendimi Subjekteve te interesuara.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.


GJYQTARE



Akt Themelimi
«United Transportation Services sh.p.k.»
Shoqeri Me Pergjegjesi Te Kufizuar

I. Themelimi

Zoti Majd Nuri Shafiq, lindur me 12 dhjetor 1961, ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne qytetin e New Yorkut, i biri i Nuriut, me numer pasaporte 102402894, banues ne rr. Pjeter Bogdani, nr.13, deklarone themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar «United Transportation Services» sh.p.k, bazuar ne ligjin «Per shoqerite tregtare» Nr. 7638, me seli ne Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane, Shqiperi.

II. Objekti

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a. Marrjen, grumbullimin dhe shperndarjen e kolive, pakove dhe zarfave normal dhe express te te gjitha llojeve dhe madhesive, brenda dhe jashte territorit te Republike se Shqiperise, me ane te transportit tokesor, detar dhe ajror.
- b. Perfaqesimin e shoqerive te huaja qe ushtrojne aktivitet ne kete lloj biznesi dhe te ofroje sherbimet e tyre ne Shqiperi.
- c. Kryerjen e te gjitha procedurave dhe formaliteteve te zhdoganimit dhe te sherbimit per vete shoqerine dhe klientet e saj (individe ose shoqeri).
- d. Kryerjen e te gjitha llojeve te sherbimit te transportit, brenda dhe jashte Shqiperise.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes profesionale.

III. Statuti

Zoti Majd Nuri Shafiq, ortak i vetem, themelues dhe administrator i "United Transportation Services sh.p.k. » deklaroi pajisjen e shoqerise me statut, te firmosur prej tij dhe te noterizuar. Statuti I aneksohet ketij akti.

IV. Nenshkrimi i Kapitalit

"United Transportation Services sh.p.k. » ka nje kapital themeltar prej 100 000 Leke, te ndare ne 100 pjese te barabarta me nje vlere 1000 Leke secila.

Kapitali nenshkruhet dhe shlyhet plotesisht nga Zoti Majd Nuri Shafiq ortak i vetem i shoqerise.

V. Shlyerja e Kapitalit

Zoti Majd Nuri Shafiq ka depozituar shumen prej 100 000 Leke, ne emer te "United Transportation Services sh.p.k. » ne formim e siper. Certifikata qe verteton kete depozitim i aneksohet ketij akti.

"United Transportation Services sh.p.k. » disponon lirshmerisht kete shume pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.

VI. Administratori


Administrator i vetem i "United Transportation Services sh.p.k. » eshte zoti Majd Nuri Shafiq.

Ortak i vetem dhe Administrator
Majd Nuri Shafiq

Majd Nuri Shafiq



Përkthyesja
Floria Tomleo Borelli





STATUTI I SHOQERISE
“UNITED TRANSPORTATION SERVICES”

SHPK

I. KRIJIMI , FORMA , EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 1

Emertimi

1.1. “United Transportation Services” sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Aktiviteti i kesaj shoqerie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare”.

NENI 2

Ortaket

2.1. Ortaku i vetem i shoqerise eshte:

MAJD NURI SHAFIQ person fizik me shtetesi amerikane, i datelindjes 1961, me adrese banimi, Rr Pjeter Bogdani, Nr 13, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Nr.102402894.

2.2. Shoqeria zhvillon veprimtari tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

2.3. Per ceshtjet qe nuk zgjidhen nga statuti, hartohet nje Rregullore.

NENI 3

Objekti

3.1. Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a. Marrjen, grumbullimin dhe shperndarjen e kolive, pakove dhe zarfave normal dhe express te te gjitha llojeve dhe madhesive, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise me ane te transportit tokesor, detar dhe ajror.
- b. Perfaqesimin e shoqerive te huaja qe ushtrojne aktivitet ne kete lloj biznesi dhe te ofroje sherbimet e tyre ne Shqiperi.
- c. Kryerjen e te gjitha procedurave dhe formaliteteve te zhdoganimit dhe te sherbimit per vete kompanine dhe klientet e saj (individe ose shoqeri).
- d. Kryerjen e te gjitha llojeve te sherbimit te transportit, brenda dhe jashte Shqiperise.

3.2. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

3.3. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes profesionale.

NENI 4

Selia

4.1 Qendra e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranës. Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranës me adrese Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta. Ajo mund te hapi dege dhe / ose filiale ne te gjitha rrethet e Shqiperise si edhe jashte Shqiperise.

NENI 5

Vula

5.1. Shoqeria ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj.



NENI 6

Kohezigjatja

6.1. Kohezigjatje e shoqerise eshte e pacaktuar.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 7

Kapitali themeltar

7.1. Vlera e Kapitalit Themeltar eshte 100 000 Leke.

7.2. Kapitali ndahet ne 100 pjese te barabarta, secila me vlere prej 1000 Leke, te nenshkruara dhe te shlyera plotesisht nga **Z. MAJD NURI SHAFIQ.**

7.3. Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

7.4. Pjeset nuk materializohen ne letra me vlere te tregtueshme por vertetohen me ane te certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

7.5. Cdo pjese e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

7.6. Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Transferimi

8.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.



8.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete dhe / ose transferimi i pjeseve ne rruge trashigimie, ne rast ndarjeje pasurie ndermjet bashkeshorteve, si dhe transferimi tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

a. Transferuesi apo trasheguesi ne rastin e transferimit ne rruge trashigimie, duhet t'i njoftoje shoqerise numrin e pjeseve qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit i transferohen pjeset.

b. Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e ortakeve brenda tre muajve nga dita e njoftimit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit tre mujor, miratimi quhet i dhene.

c. Asambleja miraton transferimin vetem me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

d. Ne rast se shoqeria refuzon transferimin, brenda tre muajve nga data e refuzimit, ortakët duhet t'i blejne pjeset e propozuara per transferim. Cmimi i shitjes eshte vlera kontabel e pjeseve (book value). Nese disa ortake jane te interesuar njeheresh ne blerjen e pjeseve, e drejta e tyre eshte proporcionale me numrin e pjeseve qe ata zoterojne. Ne rast se asnje ortak nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Asambleja duhet te vendose, me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, nese: 1. pjeset do t'i shiten personit te propozuar nga transferuesi me çmimin e rene dakort midis tyre; 2. pjeset do t'i shiten nje personi tjeter te trete me çmimin e rene dakort me kete person por jo me pak se vlera kontabel e tyre; 3. pjeset do te blihen nga shoqeria per tu anuluar, ne kuadrin e nje zvoglimi kapitali, ne perputhje me nenin 64 Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

8.3. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

NENI 9

Zmadhimi

9.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, ne perputhje me nenet 62 dhe 63, Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.

9.2. Ortaket kane te drejten e rritjes ne menyre proporcionale (ne te njejten mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne). Askush nuk mund te favorizohet apo te defavorizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit (parimi i trajtimit te barabarte).

9.3. Megjithate, ne asnje rast, ortaket qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, nuk mund te detyrojne nje apo disa ortake te minorances per te rritur angazhimin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise. Ne kete rast, kapitali rritet ne menyre proporcionale ndermjet ortakeve qe kane pranuar zmadhimin e tij; pjeset e ortakeve ne minorance qe nuk pranojne te rrisin kontributin e tyre, mbeten te pandryshuara.

9.4. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve ne para, te gjitha pjeset e reja duhet te nenshkruhen dhe shlyhen teresisht. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesit per llogari te shoqerise. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas regjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Regjistrin Tregtar. Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk regjistrohet ne regjistrin tregtar brenda gjashte muajsh qe nga data e depozitimit te pare te fondeve, kontribuesit kane te drejte individualisht ose bashkarisht, te kerkojne ne rruge gjyqesore autorizim per terheqjen e shumes se kontributeve te tyre.



NENI 10

Zvoglimi

10.1. Zvoglimi i kapitalit deri ne nje vlere jo me te vogel se 100 000 Leke mund te kryhet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, ne perputhje me nenin 64, Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

10.2. Zvoglimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.

10.3. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, duhet te vendosin ose prishjen e shoqerise, ose zvoglimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen 100 000 Leke, ne perputhje me nenet 72 dhe 38, Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 11

Asambleja e ortakeve

11.1. Vendimet merren nga asambleja e ortakeve.

11.2. Çdo ortak ka te drejte te marri pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjetër ose nga nje mandatmbajtës i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson.

11.3. Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt, çdo vit, brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar. Asambleja mund te thirret ne çdo kohe me kerkesen e: a. nje apo disa ortakeve qe perfaqesojne 10% te pjeseve te kapitalit themeltar, b. ekspertit kontabel te autorizuar, c. te administratorit, d. te likujduesit.

11.4. Administratori iu njofton te gjithë ortakeve, Mbledhjen e Asamblese, me leter rekomande, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen dhe rendin e dites se Mbledhjes. Cdo ortak mund te anulloje mbledhjen e asamblese se thirrur ne menyre te parregullt. Megjithate, nuk mund te anulohen mbledhjet e thirrura ne menyre te parregullt, nese te gjithë ortaket kane qene te pranishem apo te perfaqesuar.

11.5. Asambleja mund te marre vendime edhe me ane te konsultimit me shkrim te ortakeve. Konsultimi me shkrim kryhet ne kete menyre: a. Administratori harton nje propozim me shkrim te vendimit qe kerkohet te aprovohet; b. Administratori iu dergon te gjithë ortakeve, propozimin me shkrim te vendimit me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; c. Ortaket kthejne nje pergjigje ekzakte nese miratojne apo refuzojne propozimin e vendimit, me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; d. Administratori mbledh miratimet dhe refuzimet dhe iu dergon te gjithë ortakeve rezultatin e votimit, me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; e. cdo ortak ka te drejte t'i kerkoje Administratorit te kontrolloje procesin e konsultimit me shkrim.

11.6. Asambleja drejtohet nga Kryetari i Asamblese ose ne mungese te tij, nga Administratori. Kryetari i Asamblese emerohet dhe ndryshohet nga Asambleja me shumice te zakonshme. Ne baze te nenit 5 te Kodit shqiptar te punes, posti i Kryetarit te Asamblese nuk rregullohet nga kontrata e punes. Kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e tij ndaj shoqerise rregullohen ne aktin e emerimit.

11.7. Kryetari i Asamblese emerone nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces - verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithë ortaket e pranishem ne mbledhje.

11.8. Votimi eshte ne parim i hapur. Me kerkese te nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit, votimi eshte sekret.

11.9. Jane ne kompetencen e vetme te Asamblese marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimi i statutit
- b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi
- c. linjat baze per zhvillimin e biznesit te shoqerise
- d. zmadhimi, zvoglimi i kapitalit
- e. miratimi i llogarive, raporti vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel te autorizuar
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave te reja
- g. marrja hua, lenia peng apo cdo barre tjeter siguruese
- h. hapja e nje aktiviteti te ri ekonomik
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit
- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar
- l. blerja e pasurive te patundshme
- m. blerja e aksioneve, certifikatave apo titujve te shoqerive te tjera tregtare, apo e cdo lloj instrumenti financiar
- n. te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe / ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

11.10. Asambleja merr vendim me shumice te zakonshme ose shumice te jashtezakonshme. Ne rast se shumica e zakonshme eshte e kerkuar, vendimet merren, ne cdo rast dhe cdo here, nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Ne rast se shumica e jashtezakonshme eshte e kerkuar, vendimet merren, ne cdo rast dhe cdo here, nga ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

11.11. Asambleja vendos me shumice te jashtezakonshme:



- a. ndryshimin e statutit
- b. transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek nje i trete
- c. zmadhimin apo zvoglumin e kapitalit themeltar
- d. blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anulimin e tyre
- e. prishjen e shoqerise ne rast se humbjet jane me te medha se gjysma e kapitalit
- f. shnderrimin e shoqerise ne shoqeri anonime

11.12. Per cdo ceshtje tjeter, Asambleja vendos me shumice te zakonshme.

11.13. Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te veçante, qe mbahet ne seline e shoqerise.

11.14. Per sa kohe shoqeria ka vetem nje ortak, kompetencat e Asamblese ushtrohen nga ortaku i vetem.

NENI 12

Administratori

12.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, nje person fizik qe mund te jete ose jo ortak i shoqerise. Asambleja, me shumice te zakonshme, mund te vendose qe shoqeria te kete me shume se nje administrator. Ne kete rast, marredheniet midis administratoreve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e secilit rregullohen ne Rregullore.

12.2. Administratori emerohet me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{1}{2}$ e pjeseve te kapitalit themeltar.

12.3. Ne baze te nenit 5 te Kodit shqiptar te punes, posti i Administratorit nuk rregullohet nga kontrata e punes. Te drejtat dhe detyrimet e tij ndaj shoqerise rregullohen ne aktin e emerimit.

12.4. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte e pacaktuar. Ai shkarkohet, me ose pa motiv, me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi ½ e pjeseve te kapitalit themeltar.

12.5. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve (kompetencave) qe ligji dhe / ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

12.6. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje ligjore , per shkelje te statutit apo per faje te tyre gjate administrimit te shoqerise.

NENI 13

Eksperti kontabel i autorizuar

13.1. Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo shoqeri). Ai caktohet me vendim te asamblese, me shumice te zakonshme.

IV. VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE , NDARJA E FITIMIT

NENI 14

Viti financiar

14.1. Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare fillon ne ditën e regjistrimit dhe perfundon ne fund.

NENI 15

Llogarite vjetore

15.1. Llogarite vjetore inventari raporte mbi operacionet e veprimtarise se viti financiar dhe raportet e veçuara te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicen e zakonshme.



- 15.2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

NENI 16

Fitimi

16.1. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha shpenzimet , si edhe fondet e lene reserve per nxitje ekonomike , per investime etj , ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitali themeltar qe ka secili ortak.

16.2. Ortakut te huaj, fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise, sipas perqindjes qe i takon, mund t'i transferoje jashte shtetit , ne perputhje me dispozitat ligjore shqiptare ne fuqi.

NENI 17

Bilanci

17.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes .

V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

NENI 18

Likuidimi

18.1. Shoqeria priset me vendim te asamblese me shumice te jashtezakonshme dhe ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise.

18.2. Ne rastin e prishjes se shoqerise, ajo kryen procesin e likuidimit ne perputhje me ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

18.3. Mbas pagimit te kreditoreve , shlyerjen e te gjithë detyrimeve dhe shlyerjen e pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ate zoterojne.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 19


Konfliktet

19.1. Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim , organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte gjykata e rrethit Tirane .

Me daten 29 dhjetor 2004, ne Tirane, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te ortaku te vetem, ky statut, ne 4 kopje origjinale, ne gjuhen shqip.

**ORTAKU I VETEM
MAJD NURI SHAFIQ**

MAJD NURI SHAFIQ



Përkthye nga

Floria Tahiro Borezi



32861/3

K E R K E S E

07

Z. Shafiq
24.09.2006

SHTATOP 2006

Tirane me ___/___/2006



[Handwritten signature]

KERKUES: UNITED TRANSPORT sh.p.k, Tirane i perfaqesuar nga Z.Niko LEKA, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit gjyqesor Tirane.me vendimin nr.32861 dt.04.02.2005.

OBJEKTI: Ndryshimi i Administratorit dhe Selise te shoqerise si dhe pasqyrimi i ndryshimeve perkatese ne Regjistrin Tregtar, ne baze te ligjit nr.7667, date 28.01.1993.

PERPARA: GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Shume i nderuar Gjykatës

Shoqeria "United Transport" shpk, me Seli ne Tirane eshte person juridik i regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane kesaj Gjykate me vendimin nr. 32861 date 04.02.2005 dhe perbehet nga dy ortakë Shoqeria UNION GRUP shpk me 76 % te kapitalit themeltar dhe z. Majd Nuri Shafiq me 24 % te ketij kapitali. Administrator i shoqerise eshte z. Majd Nuri Shafiq. Selia e shoqerise eshte ne rrugen Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane.

Ne Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve te mbajtur ne daten 14.08.2006 te kesaj shoqerije, Ortaket e shoqerise vendosen si me poshte vijon:

1. Pranimin e doreheqjes Z.Majd Nuri Shafiq nga detyra e Administratorit te shoqerise
2. Emerimin e Administratorit te ri z. Niko LEKA, ne vend te Administratorit te meparshem z.Majd Nuri Shafiq.
3. Ndryshimin e Selise te shoqerise nga Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane ne adresen e re: **Bulevard Zogu I, Pallati Edicom, perballe Stacionit te Trenit Tirane.**

[Handwritten signature]


Ju lutemi te shqyrtoni kerkesen tone dhe te vendosni perkatesisht per pasqyrimin e vendimit te asamblese se Ortakeve ne Regjistrin tregetar te kesaj Gjykate.

Bashkangjitur vendimi i Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "United Transport"sh.pk te dates 14 Gusht 2006, qe pasqyron keto ndryshime.

Me Respekt,

"UNITED TRANSPORT"sh.pk

Perfaqesuar nga Z.Niko Leka

Niko Leka


V E N D I M

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE “ United Transport” shpk

Sot ne daten, 14.08.2006, u mblodh Asambleja e jashtezakonshme e ortakeve te shoqerise **United Transport** shpk, ne Seline e kesaj shoqerise, ne Tirane dhe shqyrtoi kete rend dite:

1. Pranimin e doreheqjes se Z.Majd Nuri Shafiq nga detyra e Administratorit te shoqerise “United Transport “ shpk Tirane
2. Emerimin e Z.Niko Leka si Administrator te ri te shoqerise.
3. Ndryshimin e Selise te shoqerise, nga “Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane”, ne adresen e re “Bulevard Zogu I, Pallati Edicom, perballe Stacionit te Trenit, Tirane.

Bazuar ne nenet 50 dhe 55 te ligjit nr.7638,date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe ne Statutin e vete shoqerise, me unanimitet te dy ortakeve, asambleja:

V E N D O S I

1. Pranimin e doreheqjes se Z.Majd Nuri Shafiq nga detyra e Administratorit te shoqerise “United Transport “ shpk Tirane
2. Emerimin e Z.Niko Leka si Administrator te ri te shoqerise.
3. Ndryshimin e Selise te shoqerise, nga “Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane”, ne adresen e re “Bulevard Zogu I, Pallati Edicom, perballe Stacionit te Trenit, Tirane.
4. Te mandatoje Z.Niko LEKA te ndjeke procedurat e nevojshme per pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKET


Majd Nuri Shafiq


Majd Nuri Shafiq



UNION GRUP sh.p.k.
Perfaqesuar nga Z.Niko Leka

Niko Leka





V E N D I M
I ASAMBLESE TE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE
UNION GRUP shpk

Asambleja e ortakeve te shoqerise **UNION GRUP** shpk,e mbledhur sot ne dt 14/08/2006 ne Seline e kesaj shoqerie,

Bazuar ne nenin 50 te ligjes "Per shoqerite tregtare" dhe nenit 12 te Statutit:

V E N D O S I

1. **Te mandatoje** Z.Niko LEKA te perfaqesoje shoqerine UNION GRUP shpk Tirane, ne mbledhjen e Asamblese te ortakeve te shoqerise "United Transport" shpk, Tirane

2. Ti jape Z.Niko LEKA tager per te votuar ne kete asamble per dy probleme:
 - a. Ndryshimin e Selise te shoqerise nga Rr. Pjeter Bogdani,Pallati Teuta, Tirane ne Bulevard Zogu I,Pallati Edicom,perballe Stacionit te Trenit.
 - b. Ndryshimin e administratorit te meparshem Z.Majd Nuri Shafiq me administratorin e ri Z. Niko LEKA.

ORTAKET

Niko LEKA

Eduard SHIMA

Varuzhan PIRANIAN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 4015 / Rep.
Nr. 1157 / Kol

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 21 / 09 / 2006, une notere Eriketa Kokoli,notere ne Tirane,me Seli ne rrugen e Durrsit,vertetova firmen e Z. **Niko LEKA**,I biri I Vlashit dhe I Margarites,lindur ne Tirane me 31.03.1961,banues ne banesen e mesiperme,me numur leternjoftimi AZ 086175; **Varuzhan PIRANIANI**,I biri I Vahramit dhe I Enenit,lindur ne 22.03.1957,banues Tirane,rruga "Muhamet Gjollesha", Pall.14, Ap.24,me numur pasaporte AZ 089508; **Eduard SHIMA**,I biri I Fejziut dhe I Haxhirese,lindur ne Tirane me 06.11.1960,banues Tirane,rruga "Myslym Shyri",pall.55/1.shk.3,ap.23,me numur pasaporte 0321631, te njohur personalisht prej meje, te vene ne kete vendim te Asamblese te ortakeve.

Une noteri pasi e gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.



NOTERI

Eriketa Kokoli
Eriketa Kokoli

V E N D I M

Dt 02.06.2006

i Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme
te Shoqerise "Union Grup" sh.p.k.



Sot ne dt 02.06.2006 ne mbledhjen e Asamblese e Pergjithshme te Jashtezakonshme te shoqerise "Union Grup" sh.p.k. u morr ne shqyrtim blerja e 76% te aksioneve te shoqerise "United Transport" sh.p.k. e cila kryen ofrimin e sherbimit korier.

Bazuar ne Statutin e shoqerise Asambleja morri vendim per sa vijon:

1. Te miratoje blerjen e 76% te aksioneve te shoqerise "United Transport" sh.p.k. ne vleften 190,000 Euro;
2. Te ngarkohet e Autorizohet administratori i shoqerise Z. Niko LEKA qe te ndermarre te gjitha hapat e nevojshme e te kryeje te gjitha procedurat e domosdoshme ne funksion te zbatimit te ketij vendimi.

ORTAKET

Niko Leke
Edmond Leka

REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr. 308 Rep.
N/222 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten Dy Qershor 2006 (dymije e gjashte),diten e premte, une notere **Eriketa Kokoli**, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen "Kont Uran"Nr 20, vertetova firmen e : **Z.Edmond Leka**,i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me 17.05.1963, banues ne Tirane, Rruga" Sulejman Delvinsa" Pall.29, shk.15, ap.89, me numer pasaporte 0126431, **Niko Leka**, i biri i Vlashit dhe i Margatites, lindur ne Tirane me 31.03.1961, banues ne banesen e mesiperme, me numer leternjoftimi AZ 086175; **te vene ne vendimin e dates 02.06.2006 te Union Grup.** Une noteri pasi e gjeta konform Ligjes e vertetova si me poshte.

PULLE TAKSE



NOTER

Eriketa Kokoli
Kokoli



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4958 Rep.


STUDIO NOTERIALE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM

Sot me date 13.07.2006 (dymije e gjashte), para meje Mimoza Sadushaj , notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. « Vaso Pasha », Pall. 13/1, u paraqit personalisht :

Av.Entela Memishaj e cila paraqiti origjinalin e Vertetimit te nenshkrimt ne dt 02.06.2006 nga noterja Eriketa Kokoli per Z.Edmond Leka dhe Niko Leka dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE
Mimoza Sadushaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

ZYRE NOTERIE

AUTORIZIM



Tirane me 2 Qershor 2006

Une i nenshkruari **MAJD NURI SHAFIQ**, i datelindjes 1961, nenshtetas amerikan, me adrese banimi Rr Pjeter Bogdani Nr 13, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes Nr.102402894, ne cilesine e Administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise "United Transport sh.p.k.", person juridik, i rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar ne baze te vendimit te Gjykates se Shkalles se rrethit Tirane, Nr. 32861, Date 4.02.2005 dhe riregjistruar me vendimin Nr. 32861/1 Date 5.07.2005 te te njejtës gjykate, ne baze te neneve 16 dhe 50 te ligjit nr. 7632 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te neneve 64 dhe 72 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise autorizoj Avokatet Flonia Tashko Boriçi, lindur me 22. 07. 1972, ne Tirane, banues ne Tirane dhe Soko Nako, lindur me 28.12.1970, ne Tirane, banues ne Tirane, se bashku ose individualisht, te perfaqesoje shoqerine "United Transport sh.p.k " te gjitha procedurat e transferimit te pjeseve te kapitalit sipas kontrates Nr. 3744 Rep, Nr. 1480 Kol, date 02.06.06 perpara Gjykates se Rrethit Tirane dhe perpara te gjitha gjykatave te tjera shqiptare.

Perfaqesuesi kane te drejte te perdorin ne emer te "United Transport sh.p.k ", te gjitha mjetet e njohura nga ligji ne funksion te qellimit te siperpermendur. Ai ka te drejte te pergatise dhe te nenshkruaj e ne emer te te perfaqesuares cdo kerkese apo dokument tjeter per realizimin e tagrave te siperpermendura. Ky autorizim ka per efekt te bej te pavlefshem cdo lloj autorizimi, akt perfaqesimi apo prokure tjeter te meparshme, ne kete ceshtje.

United Transport sh.p.k

Administrator

Majd Nuri Shafiq

MAJD NURI SHAFIQ

AUTHORIZATION



I, the undersigned **MAJD NURI SHAFIQ**, born in 1961, American citizen, residing in Rr Pjeter Bogdani Nr 13 Tirana Albania, holder of the passport Nr.102402894, in my capacity as the only Shareholder and Administrator of «United Transport sh.p.k.», a legal person registered with Commercial Registry in pursuance of the Decision No. 32861 of District Court of Tirana on 4.02.2005, and re-registered in pursuance with Decision No 32861/1 on 05.07.2005 of the said Court, in pursuance of Articles 64 and 72 of the Civil Code of the Republic of Albania and Articles 16 and 50 of the Law No 7632 "On Commercial Companies", hereby grant this authorization to the attorneys Flonia Tashko Boriçi, born on 22. 07. 1972, in Tirana, residing in Tirana, and Sokol Nako, born on 28.12.1970 in Tirana, residing in Tirana, to represent together or individually, "United Transport sh.p.k." in the procedures of Capital Parts Transfer according the contract Nr. 3744 Kol , Nr. 1480 Rep, date 02.06.06, before the District Court of Tirana and any other court of this or any other instance.

The attorney shall act on behalf of "United Transport sh.p.k." with all legal means under the law in order to accomplish abovementioned purpose. He is authorized to prepare and sign on behalf of the represented petitions or any other document to accomplish his powers. This authorization supersedes any previous authorization, representation or any other powers-of-attorney in this case.

Majd Nuri Shafiq

Administrator

United Transport sh.p.k

MAJD NURI SHAFIQ

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 3144 REP NR 1480 KOL

NOTERIA PUBLIKE MIMOZA SADUSHAJ



Kontrate Shtiblerjeje dhe Transferimi te Pjeseve te Kapitalit

Sot me date 2 Qershor, 2006, ne Tirane, u paraqiten perpara meje noteres Mimoza Sadushaj ,anetare e Dhomes se Notereve, ne Tirane,palet qe do te lidhin kete kontrate:

Z.Majd Nuri Shafiq (me poshte referuar si "Shitesi"), lindur me 12 Dhjetor, 1961, ne qytetin e New York, NY, USA, i biri i Nuriut, mbajtes i pasaportes me nr 102402894, rezident ne Shqiperi, me adrese Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, Tirane,

dhe

Union Grup sh.p.k. (me poshte referuar si "Bleresi"), me qender ne Bulevardin Zogu I, Pallati Edi-Com 13 Katesh, Tirane, Shqiperi, regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendim nr.26016 Date 26.05.2001 e perfaqesuar nga Z. Niko Leka ne cilesine e Administratorit te shoqerise.

Megenesese ekzistojne keto kushte paraprake

- a) United Transport sh.p.k (me poshte referuar si, "Shoqeria"),eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar konform legjislacionit shqiptar , me seli ne Rr. Pjeter Bogdani, Pallati Teuta, Tirane Shqiperi, me Kapital 100 000 (nje qind mije) leke te paguar teresisht,e regjistruar me vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me Nr.32861, Date 04.02.2005 dhe Nr. 32861/1, date 05.07.2005;
- b) Shitesi eshte pronar i 100 (nje qind) pjeseve te kapitali me vlere nominale 1,000 (nje mije) leke secila, qe perfaqesojne 100% te kapitalit te emetuar te Shoqerise;
- c) Bleresi eshte nje Shoqeri e themeluar konform legjislacionit shqiptar;
- d) Shitesi do ti shese Bleresit 76 (shtatedhjete e gjashte)pjese te kapitalit te Shoqerise, qe perfaqesojne 76% te kapitalit te emetuar nga Shoqeria;
- e) Bleresi do te bleje 76 (shtatedhjete e gjashte) pjeset e kapitalit, qe jane ne pronesi te Shitesit.

Per sa me siper, ne perputhje me Kodin Civil Shqiptar dhe Ligjin No 7638 date 19.11.1992, per Shoqerite Tregetare Shqiptare, PALET BIEN DAKORD si me poshte:

NENI 1

PERKUFIZIME

Ne vijim te termave te tjera te perkufizuara ne kete Marreveshje dhe me kete qellim, fjalet dhe termat e meposhtme do te kene kudo kuptimin qe jepet me poshte:

"Llogari" do te thote llogari e kompanise per vitin financiar qe perfundon ne Daten e Fundit te Llogarise, qe perfshin raportin statutor te kontroll-revizionit ne lidhje me keto llogari, raportin e drejtuesit dhe shenimet per keto llogari;

"Marreveshje" kupton kete Marreveshje per Blerje te Pjeseve te Kapitalit - qe perfshin si pjese perberese te saj, kushtet paraprake te mesiperme dhe shtojcat e bashkengjitura - zbatuar dhe ndryshuar nga dhe mes Bleresit dhe Shitesit;

"Mbyllje" kupton blerjen dhe shitjen e Pjeseve te Kapitalit, regjistrimin e bleresit si ortak i ri, pagimin e pjeses te cmimit te pagueshem ne Daten e Mbylljes, dhe ne pergjithesi nenshkrimi dhe shkembimi i te gjitha dokumenteve dhe kryerjen dhe permbushjen e te gjitha detyrimeve, te kerkuara respektivisht per t'u nenshkruar, shkember, kryer dhe permbushur ne Mbyllje ne vijim te kesaj Marreveshje, ne menyre qe te legjitimoje bleresin si pronar te ri te 76% te Pjeseve te Kapitalit te shoqerise:

"Date e Mbylljes" do te thote data ne te cilen aktualisht do te ndodhe Mbyllja sipas parimeve qe parashikohen ne kete Marreveshje, jo me vone se 30 dite pas kryerjes se kesaj Marreveshje.

"Pagese e menjehershme" do te thote sasia prej 40 000 (Dyzet mijë) EURO, e paguar prej Bleresit ne momentin e Mbylljes sic parashikohet ne nenin 3, paragrafin 3, numer 1 i kesaj Marreveshje;

"Barre" do te thote cdo garanci, kapar, peng, interesa sigurimi, kufizim, e drejta per refuzimin e pare, e drejta e parablerjes, e drejta e 1/3 te pjeses ose interesit, hipoteke ose cdo lloj tjetër rregullimi preferencial (duke perfshire pa asnje kufizim, nje transferte titulli ose marreveshje mbajtje, qe ka efekt te ngjashem ;

"Force Madhore" do te thote cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise, e shpallur ne formen e ligjit apo ne tjetër menyre, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, rremuje, trazire kryengritje popullore, lufte (e deklaruar ose jo), aksione terroriste ose guerrilase te grupeve apo te individeve te vecante, greva apo shqetesime te tjera te punes te kesaj natyre, zjarre, termete, apo cdo lloj shkak tjetër qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre dhe qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin.

"Dita e Fundit e Llogarise" do te thote 30.06.2006 ;

"Dem" ose "Deme" do te thote demtime, kosto, shpenzime te shkaktuara, humbje, ose detyrim qe jane pasoje direkte e shkeljes se garancive ose deklarimeve qe jepen ne nenin 5

"Material" (dhe variantet e tij) do te thote, shfaqja e nje ngjarje, rrethane, fakt apo kusht, dhe qe kjo ngjarje, rrethane, fakt apo kusht-individualisht apo ne teresi- te kete nje ndikim thelbesor dhe/ose nje efekt demtues ekonomik, trashegimor, financiar dhe pozicionimi ne treg per shoqerine dhe/ose per veprimtarine e saj, dhe qe vendimi per te kryer transaksionin te mund te jape efektin e kundert ne rast se verifikohet kjo ngjarje, rrethane, fakt ose kusht qe mund te boje ne prodhimin e nje efekti te kundert.

"Material me efekt te kundert" do te thote cdo efekt ne veprimtarine e shoqerise qe sjell nje pagese ose nje humbje, individualisht apo ne teresi, ne nje vlere jo me te vogel se 10 000 (dhjete mije) Euro.

"Pale" ose "Palet" do te thote Shitesi ose Bleresi ose te dy palet sipas kontekstit:

"Cmim i Blerjes" do te thote cmimi i paguar prej Bleresit per blerjen e Pjeseve te Kapitalit sic tregohet ne nenin 3 dhe ne perputhje me mekanizmin e percaktuar per te ;

"Shpallje e Cmimit te Blerjes" do te thote deklarimi i shkruar, ne formen e rene dakord ne Aneksin A, nenshkruar prej zyrtareve perkates te seciles prej bankave te percaktuara nga Bleresi duke vertetuar qe Cmimi i blerjes eshte kredituar ne llogarine e Shitesit, ose te enteve te tjera te percaktuara nga Shitesi, - dhe te treguara ne tabelen ne nenin 3 -

"Kontrate Sherbimi" do te thote kontrata midis UPS dhe United Transport sh.p.k

"Pjese te kapitalit" do te thote numer 76 (shtatedhjete e gjashte) pjese, te paguara plotesisht ne kapitalin e shoqerise me nje vlere te barabarte me 1,000 leke secila, qe i korrespondojne 76% te kapitalit te emetuar ne pjese kapitali te shoqerise. Pjeset e kapitalit perfaqesohen prej certifikates te paraqitur ne Aneksin B.

"UPS" do te thote UPS WORLDWIDE FORWARDING Inc nje shoqeri e Delaware, me adrese 55 Glenlake Parkway NE ,Atlanta, Georgia 30328, Usa.

Titujt ne kete Marreveshje nuk influencojne ne interpretimin e saj.

NENI 2

OBJEKTI KESAJ MARREVESHJE

